



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.4131/2025

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 11, 40, Ligjit Nr. Ligjit Nr. 03L/-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 20, Ligji mbi Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-49 neni 2, Qarkorja Buxhetore 2026/01 me Nr.1508/2025 e datës 15.05.2025, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datën 26.06.2025 merr këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE TË KOMUNËS HANI I
ELEZIT PËR VITET 2026-2028

1. Kuvendi i Komunës miratoi kërkesën me nr.**04/4431/2025** të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028, e cila përmban planifikimet nga financimet qeveritare dhe nga të hyrat vetanake të komunës për vitet 2026-2028. Planifikimi i buxhetit për vitin 2026 është në shumë prej 4,234,682.00 €, për vitin 2027 në shumë prej 4,457,136.00 € si dhe për vitin 2028 në shumë prej 4,672.491.00 €.
2. Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028 përmban qëllimin, objektivat dhe parashikimet për vitet vijuese dhe është pjesë përbërse e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë, pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive Komunale,
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Data : 26.06.2025
Hani i Elezit

Kryesues i Kuvendit
Florim Shkreta





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 4118/2025

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Kuvendi i Komunës së Hani të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.06.2025 merr:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2026

1. Kuvendi i komunës miratoi propozim vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2026.

2. Grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit përbehet prej 5 (pesë) anëtarëve dhe i njëjti do të ketë këtë përbërje:

1. Florim Shkreta - PDK
2. Xhevahir Dernjani -PDK
3. Sherif Berisha -LVV
4. Hyrijete Isufi - LDK
5. Nora Xhoni- AAK

3. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e grupit punues,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 26.06.2025





01/Nr. 4546/2025

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 53 pika 3, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.06.2025 merr:

VENDIM

PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NUMËR 01/NR.469/2012

1. Kuvendi i komunës miratoi propozim vendimin me numër 02/Nr.4546/2025 për rritjen e shumës së shpenzimeve mortore sa i përket arkivoleve të OVL-UÇK-së duke miratuar kërkesën e tyre me numër 02/Nr.4535/2025, ndërsa pjesa tjetër e vendimit për rritjen e shumës së shpenzimeve të rasteve të tjera mortore prej 250 € mbetet e njëjtë.
2. Pagesa e arkivoleve për veteranët e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL-UÇK) sipas nenit 1 të këtij vendimi është në shumë prej 220 € e cila do të realizohet përmes Bashkësisë Islame dega Hani i Elezit.
3. Duke ju referuar nenit dy (2) të këtij vendimi mjetet do të ekzekutohen:
 - Kategoria e shpenzimeve-subvencione dhe transfere ,
 - Parandalimi dhe Inspektimi i zjarreve (18444), kodi funksional (0320),
 - Burimi i fondeve –të hyrat vetanake (21,22).
4. Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.
5. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendimi njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- OVL-UÇK-së -dega në Han të Elezit
- Bashkësisë Islame- dega në Han të Elezit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 26. 06. 2025

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.4339/2025

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 11, 12, 40, Ligjit Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, neni 16, paragrafi 11, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datën 26.06.2025 merr këtë:

VENDIM
PËR RIALOKIM TË MJETEVE NË KATEGORINË BUXHETORE SHPENZIME
KAPITALE

1. Kuvendi i Komunës miratoi kërkesën me nr.**04/4339/2025** të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për rialokim të mjeteve në kategorinë Shpenzime Kapitale.
2. Rialokimi i mjeteve në kategorinë Shpenzime Kapitale është në shumë prej **34,500.00 €** nga fondi (10).

Në kuadër të nën-programit Parandalimi dhe Inspektimi i Zjarreve (18444), kodi funksional (0320).

Rialokohet nga projekti:

- “Ndërtimi (ngritja e deponisë) për mbetje të ngurta (inerte)”, kodi i projektit (55036), në shumë prej 1,000.00 €, fondi burimor (10).

Rialokohet në projektin:

- “Shtimi i kapaciteteve të ujit në Lagjen e Re dhe në Han të Elezit, kodi i projektit (55080), në shumë prej 1,000.00 €.

Në kuadër të nën-programit Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66480), kodi funksional (0620).

Rialokohen nga projektet:

- Ndërtimi dhe rregullimi i këndeve të lojërave në Han të Elezit dhe fshatrat Gorancë, Paldenicë, Seçishtë “, kodi i projektit (51722), në shumë prej 5,000.00 €, fondi burimor (10),
- “Ndërtimi i parkut në fshatin Paldenicë”, kodi i projektit (55041), në shumë prej 7,000.00 €, fondi burimor (10),
- “Rregullimi i prockave dhe kanalizimeve atmosferike në fshatrat: Paldenicë, Rezhancë dhe Seçishtë”, kodi i projektit (55045), në shumë prej 5,000.00 €, fondi burimor (10),

- “Ndërtimi i rrugës Hani i Elezit – Dimcë”, kodi i projektit (56252), në shumë prej 3,000.00 €, fondi burimor (10),
- “Rregullimi i rrugës Fujza – Vërtomicë”, kodi i projektit (56256), në shumë prej 5,000.00 €, fondi burimor (10),
- “Shtrimi me zhavorr i rrugës prej burimit të fshatit Seçishtë deri te Lloka”, kodi i projektit (56287), shuma prej 3,000.00 €, fondi burimor (10).

Riallokohen në projektet:

- “Ndërtimi (Rihapja, zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Paldenicë, Pustenik, Seçishtë, Gorancë, Dimcë, Krivenik” kodi i projektit (53484), në shumë prej 10,000.00 €,
- “Shtrimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Pustenik, Gorancë, Dermjak, Rezhancë, Krivenik” kodi i projektit (53471), në shumë prej 18,000.00 €.

Në kuadër të nën-programit Administrata – Hani i Elezit (92175), kodi funksional (0980).

Riallokohen nga projektet:

- “Ndërtimi i objektit të SHFMU në Lagjen e Re”, kodi i projektit (56033), në shumë prej 3,000.00 €, fondi burimor (10),
- “Ndërtimi i çerdhes në Lagjen e Re”, kodi i projektit (56037), në shumë prej 2,500.00 €, fondi burimor (10).

Riallokohen në projektin:

- “Rregullimi i infrastrukturës shkollore në SHML - Dardania, SHFMU - Ilaz Thaçi, SHFMU - Kështjella e Diturisë dhe SHMFU - Veli Ballazhi, Institucioni Parashkollor "Ardhmëria", kodi i projektit (56028), në shumë prej 5,500.00 €.

3. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë, pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive Komunale,
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Data : 26.06.2025

Hani i Elezit





Republika e Kosovës - Republic of Kosovo

Komuna – Municipality

Hani i Elezit



01/4495/2025

Në mbështetje të neneve 12, 16 dhe 17 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neni 2, paragrafi 2.3 i Ligjit Nr. 03/L-049 – Për Financat e Pushtetit Lokal, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit neni 65, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.06.2025 merr:

VENDIM

PËR RRIJTJEN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT NGA TEJKALIMI I PROJEKSIONIT TË TË HYRAVE VETANAKE PËR VITIN 2025

Neni 1

Miratohet kërkesa me **Nr.04/4495/2025** për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i projeksionit të të hyrave vetanake për vitin 2025. Projektioni i të hyrave vetanake komunale për vitin 2025 është në shumë prej 339,719.00 €, inkasimi deri më datë 05.06.2025 është në shumë prej 1,098,944.32 €. Tejkalimi i projeksionit të të hyrave vetanake deri më datë 05.06.2025 është në shumë prej 759,225.32 €.

Neni 2

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi planifikohen të destinohen si vijon:

Duke marrë parasysh këtë tejkalim deri më datë 05.06.2025, propozojmë që këto mjete të alokohen në këto Nën-Programe dhe Kategori Buxhetore, si vijon:

1. Në kuadër të kategorisë buxhetore Mallra dhe Shërbime në shumë prej **392,513.29 €** në këto Nën-Programe Buxhetore:
 - Zyra e Kryetarit (16035), kodi funksional (0111) në shumë prej 75,013.29 €,
 - Zyra e Kuvendit Komunal (16935), kodi funksional (0111) në shumë prej 2,000.00 €,
 - Administrata (16335), kodi funksional (0133), në shumë prej 55,000.00 €
 - Buxheti (17535), kodi funksional (0112), në shumë prej 3,500.00 €,
 - Parandalimi dhe inspektimi i zjarreve (18444), kodi funksional (0320), në shumë prej 10,000.00 €
 - Pylltaria dhe inspektimi (47115), kodi funksional (0422), në shumë prej 3,000.00 €
 - Turizmi (48075), kodi funksional (0473), në shumë prej 3,000.00 €,

- Planifikimi urban dhe inspeksioni (66480), kodi funksional (0620), në shumë prej 26,000.00 €,
 - Shërbimet e shëndetësisë primare (75050), kodi funksional (0721), në shumë prej 36,000.00 €,
 - Shërbimet Kulturore (85035), kodi funksional (0820), në shumë prej 24,000.00 €
 - Administrata e Arsimit (92175), kodi funksional (0980) në shumë prej 155,000.00 €
2. Në kuadër të kategorisë buxhetore Shpenzime Komunale në shumë prej **20,000.00 €**, në këto Nën-Programme Buxhetore:
- Shërbimet Kulturore (85035), kodi funksional (0820), në shumë prej 12,000.00 €,
 - Shërbimet e shëndetësisë primare (75050), kodi funksional (0721), në shumë prej 4,000.00 €,
 - Arsimi parashkollor dhe çerdhet (92890), kodi funksional (0911), në shumë prej 4,000.00 €.
3. Në kuadër të kategorisë buxhetore Subvencione dhe Transfere në shumë prej **25,000.00 €**, në këto Nën-Programme Buxhetore:
- Zyra e Kryetarit (16035), kodi funksional (0111) në shumë prej 10,000.00 €.
 - Pylltaria dhe inspeksioni (47115), kodi funksional (0422), në shumë prej 15,000.00 €
4. Në kuadër të kategorisë buxhetore Shpenzime Kapitale, në shumë prej **321,712.03€**, në këto Nën-Programme Buxhetore:
- Parandalimi dhe Inspektimi i Zjarreve (18444), kodi funksional (0320), në shumë prej 3,500.00 €, në këtë projekt kapital:
 - “Shtimi i kapaciteteve të ujit në Lagjen e Re dhe në Han të Elezit” kodi i projektit (55080), në shumë prej 3,500.00 €.
 - Planifikimi urban dhe inspeksioni (66480), kodi funksional (0620), në shumë prej 141,969.00 € në këto projekte:
 - “Shtrimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Pustenik, Gorancë, Dermjak, Rezhancë, Krivenik kodi i projektit (53471), në shumë prej 21,269.00 €,
 - “Rregullimi i varrezave të qytetit dhe fshatrat Gorancë, Pustenik dhe Rezhancë” me kod (55039), në shumë prej 23,000.00 €,
 - “Ndërtimi i mureve mbrojtëse në Lagjen e Re dhe në fshatrat: Paldenicë, Dermjak, Pustenik, Seçishtë, Gorancë, Krivenik, Dimcë”, kodi i projektit (52894), në shumë prej 41,000.00 €.
 - “Ndërtimi dhe rregullimi i parkingut në afërsi të xhamisë në fshatin Paldenicë”, (i ri), në shumë prej 22,700.00 €
 - “Rregullimi i rrugës prej te burimi deri në Lepenc”, me kod (56267), në shumë prej 34,000.00 €.

- Turizmi (48075), kodi funksional (0473), në shumë prej 63,100.00 €, në këtë projekt:
“Rregullimi i hapësirave turistike në Han të Elezit dhe në fshatrat: Pustenik, Krivenik, Seçishtë, Paldenicë, Gorancë “, kodi i projektit (55046), në shumë prej 63,100.00 €.
- Shërbimet Kulturore (85035), kodi funksional (0820), në shumë prej 73,143.03 €, në këtë projekt:
“Renovimi i sallave sportive në shkollat: SHFMU "Ilaz Thaçi", SHFMU "Veli Ballazhi" dhe "Kështjella e Diturisë" kodi i projektit (56110), në shumë prej 73,143.03 €.
- Administrata e Arsimit (92175), kodi funksional (0980) në shumë prej 40,000.00 €, në këtë projekt:
“ Investime në Pajisje të IT-së në shkollat SHML "Dardania", SHFMU "Ilaz Thaçi", SHFMU "Veli Ballazhi" dhe SHFMU "Kështjella e Diturisë", kodi i projektit (56091), në shumë prej 40,000.00 €.

Hani i Elezit
Data: 26.06.2025

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

